

PERCEPTIMET E QYTETARËVE NDAJ SIGURISË PUBLIKE, KËRCËNIMEVE TË BRENDSHME DHE TË JASHTME

PERSPEKTIVA E QYTETARËVE TË KOSOVËS



Autor:
Shpat Balaj

Metodologjia dhe rishikimi:
Mentor Vrajolli

Versioni original i këtij raporti është shkruar në gjuhën Angleze.

© Të gjitha të drejtat i rezervon Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Ndërlidhura mbrojnë të drejtat dhe pronësinë intelektuale. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem mbajtës ose të transmetohet, në çfarëdo forme a me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik a tjetër, pa lejen me shkrim nga botuesi. Përdorimi komercial i të gjitha produkteve të publikuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) nuk lejohet pa miratimin me shkrim të QKSS. Ju lutemi kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e informacionit të mbledhur nga të anketuarit dhe paraqesin vetëm perceptim e qytetarëve. Raporti kurrsesi nuk është vlerësim përfundimtar i cilësisë së punës së institucioneve që shqyrtohen në këtë studim. Ai do të shërbejë si instrument për adresimin e mangësive të mundshme, por edhe si tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me njerëzit.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptim i të anketuarve dhe nuk paraqesin detyrimisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Opinionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë detyrimisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy (NED).

PERCEPTIMET E QYTETARËVE NDAJ SIGURISË PUBLIKE, KËRCËNIMEVE TË BRENDSHME DHE TË JASHTME

PERSPEKTIVA E QYTETARËVE TË KOSOVËS

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME.....	1
PERCEPTIMET E QYTETARËVE MBI SIGURINË PUBLIKE	2
PERCEPTIMET E QYTETARËVE MBI KËRCËNIMET E BRENDSHME DHE TË JASHTME NDAJ SIGURISË KOMBËTARE TË KOSOVËS	7
KËRCËNIMET E BRENDSHME.....	7
KËRCËNIMET E JASHTME.....	10
METODOLOGJIA.....	12

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Ky botim special i BSBP paraqet perceptimin e qytetarëve mbi çështjet e sigurisë publike dhe kërcënimet kryesore të brendshme dhe të jashtme ndaj sigurisë në Kosovë. Kapitulli i parë i raportit shqyrton se sa të sigurt ndihen qytetarët në komunitetet e tyre përkatëse dhe Kosovë në përgjithësi. Për më tej, kapitulli i sigurisë publike përfshin perceptimin e qytetarëve për çështje të ndryshme që potencialisht rrezikojnë komunitetin. Kapitulli i dytë përbëhet nga perceptimet e qytetarëve se cilat janë kërcënimet kryesore të brendshme dhe të jashtme për sigurinë kombëtare të Kosovës dhe paraqet mendimet e tyre se sa disa fenomene paraqesin kërcënim për sigurinë e Kosovës. Gjetjet kryesore të këtij raporti janë:

-Të anketuarit ndjehen të sigurt në komunitetet e tyre të afërta. Megjithatë, rezultatet tregojnë prirjen që ndjenja e pasigurisë të rritet në një masë të vogël ndërsa të anketuarit zgjerohen përtej komuniteteve të tyre të afërta;

-Kur iu kërkua të identifikonin një kërcënim ndaj komunitetit pa pasur definim të ndonjë opsioni të paracaktuar se cilat do të ishin kërcënimet e mundshme, shumica e të anketuarve (43 përqind) deklaruan se nuk ka fare kërcënime brenda komuniteteve të tyre përkatëse;

-Kur u paraqitën opsione të paracaktuara për fenomene të ndryshme që potencialisht rrezikojnë komunitetin, 64 përqind e të anketuarve pohuan se emigrimi i qytetarëve të Kosovës është kërcënim i lartë ose kërcënim shumë i lartë për komunitetin;

-Kur iu kërkua të identifikonin kërcënimet kryesore të brendshme të sigurisë kombëtare, pa opsione të paracaktuara se cilat do të ishin kërcënimet e mundshme, 24 përqind e të anketuarve renditën korrupsionin/nepotizmin si kërcënimin kryesor të brendshëm;

-Kur të anketuarve ju paraqitën opsione të paracaktuara për fenomene të ndryshme që potencialisht rrezikojnë sigurinë kombëtare të Kosovës, 88 përqind e të anketuarve ndanë mendimin se papunësia është kërcënim i lartë ose shumë i lartë për sigurinë kombëtare të Kosovës;


-Lidhur me kërcënimet e jashtme të sigurisë kombëtare, 44 përqind e të anketuarve besojnë se Serbia është kërcënimi më i madh i jashtëm për sigurinë e Kosovës.

PERCEPTIMET E QYTETARËVE MBI SIGURINË PUBLIKE


Njëra nga çështjet kryesore të analizuara përmes anketës së Barometrit Kosovar të Sigurisë, përkatësisht Barometrit të Sigurisë të Ballkanit Perëndimor, ishte perceptimi i të anketuarve mbi çështjet e sigurisë publike. Përmes pyetjeve mbi këtë temë, qytetarët patën mundësinë të shprehnin shkallën në të cilën ndiheshin të sigurt në shtëpitë e tyre, lagjet, fshatrat/qytetet dhe në Kosovë në përgjithësi. Për më tej, një pyetje e hapur u ofroi të anketuarve mundësinë për ta identifikuar atë që ata personalisht e perceptojnë si kërcënimin më të madh për komunitetet e tyre përkatëse. Përgjigjet në pyetjen e hapur u analizuan dhe u grupuan në kategori, bazuar në shpeshësinë e përgjigjeve të ndryshme. Si vazhdim i pyetjes së hapur, të anketuarit patën mundësinë të vlerësonin se sa kërcënim paraqet një fenomen i caktuar për komunitetin.

Në përgjithësi, qytetarët ndihen të sigurt në komunitetet e tyre, megjithatë rezultatet tregojnë prirjen se ndjenja e pasigurisë rritet ndërsa të anketuarit zgjerohen nga komunitetet e tyre të afërta. 95 përqind e të anketuarve ndihen shumë të sigurt ose kryesisht të sigurt në shtëpitë e tyre, ndërsa 94 përqind e tyre deklaruan se ndihen shumë të sigurt ose kryesisht të sigurt në lagjet e tyre. Në anën tjetër, 91 përqind e të anketuarve ndihen shumë të sigurt ose kryesisht të sigurt në fshatin/qytetin e tyre. Për dallim nga shtëpitë dhe lagjet, ka rritje të vogël të ndjenjës së pasigurisë në këtë rast: 9 përqind e të anketuarve pohuan se ndjehen kryesisht të pasigurt ose disi të sigurt në fshatin/qytetin e tyre. Ndërsa, kur u pyetën se sa të sigurt ndihen në Kosovë në përgjithësi, 28 përqind e të anketuarve deklaruan se ndihen shumë të pasigurt, kryesisht të pasigurt ose disi të sigurt. Ndonëse pasiguria vërehet se është më e lartë në Kosovë në përgjithësi kur krahasohet me shtëpitë, lagjet dhe fshatrat/qytetet, shumica e të anketuarve, përkatësisht 72 përqind e tyre, megjithatë ndihen shumë të sigurt ose kryesisht të sigurt në Kosovë.

FIGURA 1 PERIMETRI I SIGURISË: SA TË SIGURT NDJEHEN QYTETARËT NË SHTËPITË E TYRE, LAGJET, FSHATRA/QYTETET DHE KOSOVA NË PËRGJITHËSI




Për më shumë, të anketuarve iu kërkua të identifikonin një fenomen që personalisht e perceptojnë si kërcënimin më të madh të komuniteteve të tyre të ngushta (lagje, fshat, qytet). Kjo ishte pyetje e hapur dhe të anketuarit patën mundësinë të japin përgjigjet pa opsione të paracaktuara në pyetësor. Rezultatet nga pyetjet e hapura tregojnë rezultate pozitive sa i përket kërcënimeve të paraqitura ndaj komuniteteve. 43 përqind e të anketuarve konsiderojnë se nuk ka ndonjë kërcënim të mundshëm në komunitetet e tyre të ngushta. Për 13 përqind të të anketuarve kafshët endacake janë problem i përbashkët, ndërsa 12 përqind e të anketuarve e perceptojnë vjedhjen e pasurisë personale si kërcënim të madh në komunitetet e tyre përkatëse. Kategoria "Të tjera" përfshin përgjigjet më pak të shpeshta të të anketuarve, të cilat po të ndaheshin në kategori të veçanta do të arrinin në më pak se 1 përqind. Kjo kategori përfshin përgjigje ku qytetarët e kanë konsideruar COVID19 dhe aspektet e tjera shëndetësore si rrezik për komunitetin e tyre, pastaj përgjigje që u referohen aspekteve politike si rrezik për komunitetin, përgjigje që lidhen me kulturën dhe mentalitetin e anëtarëve të komunitetit ose çështje specifike të të anketuarve që i perceptojnë si kërcënim për komunitetin e gjerë.



Pas pyetjes së hapur, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin se sa opsionet e paracaktuara që përbëhen nga fenomene të ndryshme rrezikojnë komunitetin e tyre. Në këtë pyetje të mbyllur, të anketuarit e renditën emigracionin e qytetarëve të Kosovës si kërcënimin më të lartë për komunitetin; 64


përqind të tyre ndanin mendimin se kjo dukuri është kërcënim shumë i lartë ose i lartë. Perceptimi ndaj emigracionit si kërcënim ndaj komunitetit lidhej kryesisht me mungesën e perspektivës për të rinjtë në Kosovë në përgjithësi dhe dobësimin e komuniteteve si rezultat i humbjes së kapacitetit dhe burimeve që të rinjtë potencialisht i sjellin komunitetit. ¹ Ngjashëm me pyetjen e hapur, kafshët endacake dhe grabitjet konsiderohen si kërcënim i lartë për komunitetin, me 59 përqind, përkatësisht 57 përqind të të anketuarve, që besojnë se këto fenomene përbëjnë një kërcënim shumë të lartë ose të lartë. Nga ana tjetër, 45 përqind e të anketuarve besojnë se komuniteti është shumë pak ose aspak i kërcënuar nga dhuna në shkollë dhe dhuna nga grupet kriminale, ndërsa 44 përqind ndajnë perceptimin e tillë ndaj vrasjeve si kërcënim për komunitetin.

FIGURA 3 PERCEPTIMI I TË ANKETUARVE MBI KËRCËNIMET KRYESORE TË SIGURISË PËR KOMUNITETIN







NGACMIMI SEKSUAL




DHUNA NË FAMILJE




PËRDORIMI I PALIGJSHËM I ARMËVE TË ZJARRIT




EMIGRIMI I QYTETARËVE TË KOSOVËS




MUNGESA E NDRIÇIMIT NË HAPËSIRAT PUBLIKE



MUNGESA E SIGURISË NË NDËRTIME



FATKEQËSITË NATYRORE



ÇËSHTJET E SHËNDETIT PUBLIK





DHUNA NGA GRUPET KRIMINALE



PERCEPTIMET E QYTETARËVE MBI KËRCËNIMET E BRENDSHME DHE TË JASHTME NDAJ SIGURISË KOMBËTARE TË KOSOVËS

Përveç sigurisë publike dhe perceptimeve të qytetarëve mbi kërcënimet e mundshme që i paraqiten komunitetit, pyetësi i BSBP u përqendrua gjithashtu në perceptimet e qytetarëve ndaj kërcënimeve të mundshme të sigurisë në nivel kombëtar. Kjo pjesë e pyetësit përbëhet nga tri pyetje, dy të hapura, ku të anketuarit patën mundësi të japin mendimin për atë që e perceptojnë si kërcënimin më të madh të brendshëm dhe të jashtëm mbi sigurinë e Kosovës. Pyetja e tretë, e ngjashme me kapitullin e mëparshëm mbi kërcënimet mbi komunitetin, kishte opsione të paracaktuara për fenomene të ndryshme për të cilat qytetarët kishin mundësi të vlerësonin se sa kërcënim paraqesin fenomenet e paracaktuara për sigurinë e Kosovës.

KËRCËNIMET E BRENDSHME


Kapitulli i pyetësit mbi kërcënimet e brendshme dhe të jashtme të paraqitura ndaj sigurisë kombëtare filloi me një pyetje të hapur që u kërkoi të anketuarve të identifikojnë një element/fenomen që besojnë se është kërcënim kryesor ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës. Në krye të listës së kërcënimeve, të identifikuara nga vetë të anketuarit, qëndron korrupsioni e nepotizmi me 25 përqind të të anketuarve që perceptojnë këto fenomene si kërcënimet më të mëdha të brendshme për sigurinë e Kosovës. 21 përqind e të anketuarve e shohin politikën e brendshme dhe institucionet lokale si kërcënim për sigurinë e Kosovës, gjë që riafirmon besimin e ulët të qytetarëve ndaj disa prej institucioneve kryesore në Kosovë.² Në kategorinë "Politika/institucionet" kemi përmbledhë përgjigjet ku të anketuarit specifikuan procese të ndryshme politike, institucione specifike dhe figura ose parti të ndryshme politike. Për më tej, 13 përqind e të anketuarve ndajnë mendimin se krimi i organizuar, përfshi përgjigjet ku specifikoheshin dhuna, droga, vjedhjet dhe vrasjet, përbëjnë kërcënim për sigurinë e Kosovës. Sikur me krimin e organizuar, 13 përqind e qytetarëve e shohin papunësinë dhe paqëndrueshmërinë ekonomike si kërcënim serioz për sigurinë kombëtare të Kosovës. Kategoria "Të tjera" përmbledh përgjigjet më pak të shpeshta që nuk përbëjnë 1 përqind të totalit dhe kryesisht përfshin përgjigje ku të anketuarit kanë identifikuar kërcënimet që konsiderohen kryesisht si të jashtme, përgjigje specifike për individë ose komunitete të caktuara që nuk janë domosdoshmërisht kërcënim për sigurinë kombëtare, si dhe përgjigjet ku të anketuarit e shohin luftën me vendet fqinje ose luftën civile si kërcënim potencial për sigurinë e Kosovës.

² Për më shumë informacion mbi besimin e qytetarëve ndaj institucioneve të Kosovës, ju lutemi referojuni: <http://www.qkss.org/en/Kosovo-Security-Barometer/Kosovo-Security-Barometer-Tenth-Edition-1380>

FIGURA 4 PYETJE E HAPUR - PERCEPTIMI I TË ANKETUARVE MBI KËRCËNIMET KRYESORE TË BRENDSHME NDAJ SIGURISË KOMBËTARE


Pas pyetjes së hapur, të anketuarit dhanë vlerësimin se sa kërcënim mbi sigurinë kombëtare të Kosovës paraqesin opsionet e parapërcaktuara të paraqitura në tabelën më poshtë. Në përgjithësi, shumica e opsioneve në pyetjen e mbyllur perceptohen si kërcënim i mundshëm për sigurinë e Kosovës. Me 88 përqind të të anketuarve që deklarojnë se papunësia është kërcënim i lartë ose shumë i lartë, ky fenomen konsiderohet si kërcënim më i lartë për sigurinë kombëtare të Kosovës. Korrupsioni perceptohet si kërcënim i lartë dhe shumë i lartë për sigurinë kombëtare nga 84 përqind e të anketuarve, ndërsa 83 përqind e të anketuarve ndajnë perceptimin e tillë për krimin e organizuar. Kriza ekonomike që rrjedh nga periudha pandemike COVID-19 perceptohet si kërcënim më i lartë se vetë COVID-19. Plot 84 përqind e të anketuarve e perceptojnë krizën ekonomike që rrjedh nga pandemia COVID-19 si kërcënim të lartë ose shumë të lartë, ndërsa 51 përqind e të anketuarve ndajnë perceptimin e tillë për vetë COVID-19. Fenomeni që perceptohet si më së paku kërcënues për sigurinë kombëtare janë Katastrofat Natyrore, me 34 përqind të të anketuarve që deklarojnë se katastrofat natyrore janë kërcënim i ulët ose nuk paraqesin aspak kërcënim. Nga ana tjetër, u vu re se qytetarët nuk kanë informacion të mjaftueshëm në lidhje me krimet kibernetike; 20 përqind e të anketuarve deklaruan se nuk kanë fare mendim për kërcënimin e mundshëm që mund të rrjedhë nga ky fenomen, ndërsa 50 përqind e të anketuarve e perceptojnë këtë fenomen si kërcënim të lartë e shumë të lartë për sigurinë e Kosovës.

FIGURA 5 PERCEPTIMI I TË ANKETUARVE MBI KËRCËNIMET KRYESORE TË BRENDSHME NDAJ SIGURISË KOMBËTARE TË KOSOVËS







EMIGRIMI I QYTETARËVE TË KOSOVËS



NDOTJA E MJEDISIT




KRIZA EKONOMIKE QË RRJEDH NGA PANDEMIA E COVID-19



DIALOGU KOSOVË-SERBI



LAJMET E RREME



KRIMET KIBERNETIKE



KËRCËNIMET E JASHTME

INë lidhje me kërcënimet e jashtme të sigurisë së Kosovës, BSBP vëzhgoi perceptimin e qytetarëve përmes një pyetjeje të hapur pa opsione të paracaktuara. Shumica e të anketuarve, përkatësisht 44 përqind, ndajnë mendimin se Serbia është kërcënim kryesor i jashtëm për sigurinë e Kosovës. Një pjesë e mirë e të anketuarve, 20 përqind e tyre, deklaruan se nuk kanë informacion se çfarë potencialisht paraqet kërcënim të jashtëm për sigurinë e Kosovës. Kategoria "Të tjera" përmbledh përgjigjet më të rralla që nuk përbëjnë 1 përqind të përgjigjeve totale dhe kryesisht përfshin përgjigje që janë më relevante për kërcënimet e brendshme ose kërcënimet

e paraqitura ndaj komuniteteve të ngushta. “Vendet dhe agjencitë e huaja” përfshin përgjigjet që u referohen vendeve dhe agjencive të ndryshme të huaja të cilat nëse kategorizohen në kategori të ndara, do të përbënin më pak se 1 përqind të përgjigjeve totale. Nga ana tjetër, “pozita e dobët ndërkombëtare e Kosovës” përmbledh përgjigjet ku të anketuarit kishin besimin se kërcënimet kryesore të jashtme për sigurinë e Kosovës janë procese të ndryshme të çështjeve të jashtme si dialogu Kosovë-Serbi, diplomacia e dobët, mungesa e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, mungesa e liberalizimit të vizave, etj. Nëse të gjitha përgjigjet e përfshira në këtë kategori do të kategorizoheshin veçmas, ato nuk do të përbënin 1 përqind a më shumë të totalit.



METODOLOGJIA

Barometri i Sigurisë së Ballkanit Perëndimor përbëhet nga një kombinim i metodave sasiore dhe cilësore të hulumtimit që ofrojnë rezultate objektive dhe të besueshme. Të dhënat e BSK janë mbledhë përmes intervistave ballë për ballë me të anketuar të zgjedhur në mënyrë të rastësishme, të kryera nga hulumtuesit në terren të QKSS-së në gjithë territorin e Kosovës. Hulumtimi në terren për edicionin e 10-të të KSB-së u krye nga 25 shtatori deri më 2 tetor 2020.

Pyetësi kryesisht përbëhet nga pyetje të mbyllura në formën e Shkallës Likert pesëpikëshe, të ndjekura nga pyetje të hapura që u lejojnë të anketuarve të japin mendimet pa opsione të paracaktuara. Mostra kombëtare paraqiti 1,132 ekonomi familjare, që përbën mostër përfaqësuese të popullsisë mbi 18-vjeçe në Kosovë. Korniza e mostrës u bazua në zonat e kodit telefonik dhe, si e tillë, përfshinte 8 rrethet e mëposhtme: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë Jugore, Mitrovicë Veriore, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.

Faza e parë e grumbullimit gjeografik u bazua në Raportin e Regjistrimit të Kosovës 2012. Faza e dytë përfshinte grumbullimin e mostrave sipas zonës komunale me një mostër të shtresuar rurale/urbane sipas numrit të familjeve. Faza e fundit ndoqi një metodë të mostrës së rastësishme duke përdorë 'metodën e ditëlindjes' më të afërt. Mostra e rastësishme siguron që secili banor në Kosovë të ketë probabilitet të barabartë për t'u zgjedhë për intervistë. Me shembullin e përdorur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë trendin e qëndrimeve dhe perceptimeve në mesin e gjithë popullatës së rritur të Kosovës në përgjithësi.

Të dhënat u verifikuan në kohë reale përmes koordinatoreve në terren që vizituan një mostër të paracaktuar familjesh pas përfundimit të anketimit në familjet përkatëse, përmes kontaktit telefonik me të gjithë të anketuarit për të konfirmuar respektimin e metodologjisë dhe disa prej përgjigjeve kryesore, si dhe duke analizuar vijimsinë logjike të përgjigjeve gjatë përpunimit dhe analizimit të të dhënave. Marzhi i gabimit është 3 përqind me një interval besimi prej 95 përqind. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave ka përfunduar duke përdorë softuerin SPSS. Për një ndarje të detajuar të të dhënave demografike të të anketuarve, ju lutemi referojuni [Barometrit Kosovar të Sigurisë botimi i 10](#).

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës“Pjetër Bogdani”

351.764.1(496.51)(047)

Balaj, Shpat
Publicperceptionstowardspublicsafety,
internalandexternalthreatsKosovoCitizensPerspective / Shpat, Balaj. - Prishtinë :
QKSS, 2021. – 12 f. : 21 cm.

ISBN 978-9951-799-29-4

ISBN 978-9951-799-29-4



9 789951 799294